

## Shembuj rastesh

**1** Dy nxënës e lusin mësimdhënësin A. që pas përfundimit të mësimit të shkojë së bashku me ta në lokalën e afërm. Ata dëshirojnë të bisedojnë me të për disa gjëra, të cilat në punëtorinë shkollore nuk mund ti zgjidhin mirë.

Mësimdhënësi kategorikisht refuzon një bisedë jashtë ndërmarrjes, e sidomos jashtë orarit të punës. Ndonëse ai pas orarit të punës nuk është i zënë me ndonjë gjë tjetër, ai u përmbahet principeve të tij.

***A është e preferueshme një sjellje e tillë?***

**2** Gjatë montimit, mësimdhënësi K., e vëren se një pjesë me rëndësi nuk është furnizuar .

Ai shkon shpejtë dhe e merr pjesën që mungon, kthehet dhe u mundëson nxënësve të përfundojnë montimin. Me këtë rast tejkalohet orari i punës. Asnjëri nuk hidhërohet! Kur ai i tregon për këtë udhëheqësit të shkollës H. ky përgjigjet me gjakftohtësi: „ Çka, keni bërë ju dhe nxënësit tuaj, është më se e vetëkuptueshme“

***Si e vlerësoni ju situatën?***

**3** Mësimdhënësi A. detyron nxënësin që normalisht punon me të majtën, të punojë me të djathtën. Deri më tani nxënësi gjithnjë ka kryer p u n ë t me sukses . Tani fillon të bie suksesi, pothuajse tërësisht mungon interesi për mësim dhe nxënësi reagon me mosbindje.

***Si mund të sqarohet kjo?***

**4** Gjatë kontrollimit të makinës s h p u e s e , mësimdhënësi A. bën vërejtje:“ Largoni anash mbeturinat! , Punoni pastër!“

Nxënësi E. ia kthen: Ju dini vetëm të jepni vërejtje! Sa shumë kam punuar dhe sa herë deri më tani kam larguar anash mbeturinat, ju nuk e shihni fare! Ju gjithnjë i futni hundët kur njeriu ende nuk e ka përfunduar punën!“

Mësimdhënësi i përgjigjet: „ Ajo çka ju tani potencuat, vetëkuptohet“

***Si e vlerësoni sjelljen e mësimdhënësit A?***

**5** Mësimdhënësi i tërheq vërejtjen nxënësit J që të pastrojë vendin e tij të punës. J. e bënë këtë - por me vullnet të mangët.

Mësimdhënësi vlerëson punën e nxënësit J: „Në të vërtetë më pëlqen puna jote. Pastrimi është pjesë e punës por nuk është shumë shqetësues. Për këtë arsye - vazhdo kështu!“

***A është sjellja e arsimtarit e preferueshme?***

**6** Mësimdhënësi P. propozon para kolegjit të arsimtarëve, që nxënësit të marrin pjesë më intenzivisht në kontrollin e mësimit dhe vlerësimit të tyre. Sipas tij, ata pjesërisht mund ta kontrollojnë vetëvehten. Kolegjet e tij protestojnë ashpër. Atëherë nuk do të kemi në dorë asnjë mjet për disiplinë. Atëherë do ti hapej dera dhe porta „padrejtësive“ .

***Si do të mund të përkrahnit argumentin e mësimdhënësit P.?***